



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

MINISTRI

Nr. 2565 prot.

Tiranë, më 29.05/2020

URDHËR

Nr. 351, datë 29.05.2020

PËR

**“MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA DHE KUFIZIMEVE PËR PARANDALIMIN
E PËRHAPJES SË COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

URDHËROJ:

1. Lejohet lëvizja në të gjithë vendin për të gjithë kategoritë (këmbësorë, biçikleta ciklomotorë dhe mjete) pa kufizim orari. Përjashtim nga ky rregull bëhet vetëm për datat 30-31 maj 2020 ku ndalohet vetëm lëvizja nga zonat e kuqe në zonat jeshile dhe anasjelltas.
2. Lejohet të kryejnë veprimtarinë e tyre të gjithë aktivitetet e nomenklaturës së aktiviteteve ekonomike, duke respektuar protokollat e sigurisë dhe rregullat e miratuara për distancimin social dhe masat higjieno-sanitare.
3. Përjashtim nga rregulli i përcaktuar në pikën 2, të këtij urdhëri, bëhet për aktivitetet e mëposhtme:
 - a. Klubet e natës
 - b. Aktivitetet kulturore, teatro, kinematë
 - c. Pishina
4. Ndalohen grumbullimet masive në vende të mbyllura apo të hapura, konferencat, tubimet, ceremonitë martesore dhe organizimet përtej familjare të ceremonive mortore deri në një urdhër të dytë.

5. Hapen parqet dhe zonat e gjelbërta, duke filluar nga data 01.06.2020.
6. Hapen kurset e formimit profesional, edukativ dhe argëtues, këndet e lojrave për fëmijë në ambientet e hapura, palestrat, qendrat e internetit, sipas protokolleve të miratuara dhe rregullat e miratuara për distancimin social dhe masat higjeno-sanitare, duke filluar nga data 01.06.2020.
7. Lejohet kryerja e konkurseve për punësim të personelit, konkurseve të shkollimit dhe specializimit duke filluar nga data 01.06.2020 sipas protokolleve të miratuara dhe rregullat e miratuara për distancimin social dhe masat higjeno-sanitare.
10. Hapen plazhet vetëm për strukturat akomoduese nga data 01.06.2020. Plazhet publike do të hapen në datën 06.06.2020, duke respektuar protokollat e miratuara dhe rregullat për distancimin social dhe masat higjeno-sanitare.
11. Lejohet lëvizja me mjetet e transportit për udhëtarët në hyrje dhe në dalje në pikat e kalimit kufitar tokësor. Personat që do të hyjnë në territorin e Republikës së Shqipërisë në pikat kufitare tokësore nuk do të kenë detyrimin e vetëkarantinimit 14 ditor, me përjashtim të rasteve të veçanta, që do të përcaktohen me urdhër të autoriteteve shëndetësore.
12. Ndalohet transporti publik i udhëtarëve qytetas, ndërqytetas dhe rrethqytetas deri në një urdhër të dytë.
13. Çdo parashikim tjetër që bie në kundërshtim më këtë urdhër, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

